



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

dogana.shqiptare

Dogana Shqiptare

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Nëntor 2025

ZHVILLOHET NË TIRANË MBLEDHJA E 16-TË E NËNKOMITETIT BE-SHQIPËRI PËR TREGTI, INDUSTRI, DOGANA DHE TATIME



Në Tiranë u zhvillua **Mbledhja e 16-të e Nënkomitetit BE-Shqipëri për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet**, një mekanizëm i rëndësishëm në procesin e vlerësimit të progresit të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 29 – Unioni Doganor. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, theksoi se ky dialog mbetet pika kryesore e bashkëpunimit me Komisionin Evropian, ku vlerësohen arritjet, adresohen sfidat dhe përcaktohen prioritetet që udhëheqin administratën doganore në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Ai nënvizoi se Dogana Shqiptare ka punuar intensivisht gjatë vitit të fundit në bashkërendim të plotë me **DG TAXUD**, duke respektuar të gjitha afatet dhe duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për të katër kriteret mbyllëse të Kapitullit 29. Delegacioni shqiptar informoi Komisionin Evropian për përfundimin e Strategjisë Shumëvjeçare të IT-së dhe Planit të detajuar të Veprimit, dokumente që përcaktojnë hapat për të siguruar ndërveprimin e plotë elektronik me sistemet doganore të BE-së që nga dita e parë e anëtarësimit.

Përfaqësuesit e Komisionit Evropian vlerësuan progresin e dukshëm të administratës doganore shqiptare në modernizimin e sistemeve, përafrimin me acquis, rritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërkufitar. Palët përmbyllën takimin duke dakordësuar prioritetet e fazës së ardhshme, përfshirë finalizimin e procesit të përafrimit dhe zbatimin e sistemeve të reja doganore.

MIRATOHET STRATEGJIA 2025-2030 PËR MODERNIZIMIN DHE HARMONIZIMIN E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT DOGANOR SHQIPTAR ME BE-NË

Këshilli i Ministrave miratoi **“Strategjinë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar me Sistemet e Bashkimit Evropian, për periudhën 2025-2030”**, së bashku me **Planin e Veprimit përkatës**. Ky dokument strategjik shënon një hap të rëndësishëm drejt përputhjes së plotë të sistemeve doganore me standardet dhe arkitekturën e teknologjisë së informacionit të BE-së.



Strategjia është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe **UNCTAD**, si dhe me asistencën teknike të **DG TAXUD**. Objektivi kryesor i strategjisë është që, deri në vitin 2030, Shqipëria të disponojë një infrastrukturë doganore tërësisht të harmonizuar me Kodin Doganor të BE-së, duke lehtësuar integrimin gradual në tregun e përbashkët evropian dhe duke konsoliduar procesin e anëtarësimit.

Strategjia synon gjithashtu harmonizimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor për sistemet e informacionit doganor, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbetet plotësisht e angazhuar në procesin e integritimit evropian, veçanërisht në Kapitullin 29 – Bashkimi Doganor, duke e konsideruar modernizimin e sistemeve të informacionit si një nga prioritetet kryesore për garantimin e funksionimit efikas të doganës si porta e parë e hyrjes dhe e fundit e daljes në tregun e përbashkët evropian.

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL KUNDËR TRAFIKIMIT PËRMES KONTEJNERËVE

Në selinë e **SELEC** në Bukuresht u zhvillua takimi i Container Security Task Force, i cili mbledhi përfaqësues të autoriteteve doganore dhe të rendit nga vendet anëtare, mes tyre edhe Administrata Doganore Shqiptare, për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të adresuar aktivitetet e paligjshme të lidhura me trafikimin përmes kontejnerëve.

Gjatë takimit u shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira mbi profilizimin e dërgesave me risk të lartë dhe përdorimin e qasjeve të bazuara në të dhëna për identifikimin e rrjeteve kriminale. Po ashtu, u diskutuan raste konkrete të bashkëpunimit ndërkufitar që kanë çuar në sekuestime të rëndësishme dhe në çmontimin e rrjeteve të krimit të organizuar transnacional.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e koordinimit më të ngushtë midis agjencive doganore, policore dhe operatorëve portualë, për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive taktikave gjithnjë në ndryshim të fshehjes së mallrave të paligjshme.



BASHKËPUNIMI DYPALËSH SHQIPËRI-ITALI, DOGANA SHQIPTARE E PRANISHME NË SAMITIN QEVERITAR NË ROMË

Në Romë u zhvillua **Mbledhja e Parë Ndërqeveritare** (Government to Government – G2G) midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Italiane, një moment historik që shënon thellimin e partneritetit strategjik mes dy vendeve dhe forcimin e bashkëpunimit në fusha kyçe të interesit të përbashkët. Në këtë aktivitet të nivelit të lartë, ku Kryeministri Edi Rama u prit zyrtarisht nga Kryeministrja e Italisë, **Giorgia Meloni**, mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, i cili ishte pjesë e delegacionit shqiptar në këtë format të rëndësishëm institucional.

Pjesëmarrja e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në këtë mbledhje nënvizon rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit dypalësh doganor, i cili është forcuar ndjeshëm sidomos pas nënshkrimit në Tiranë të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Shqipërisë, Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve Italiane dhe Guardia di Finanza-s italiane. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbetet e angazhuar në vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me partnerët italianë, me qëllim forcimin e sigurisë kufitare, rritjen e transparencës dhe modernizimin e proceseve, në funksion të interesit publik dhe të përbushjes së standardeve europiane.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE NË FORUMIN NDËRKOMBËTAR PËR LUFTËN KUNDËR EVAZIONIT FISKAL

Në Tiranë u organizua forumi ndërkombëtar i programit **“Tax Inspectors Without Borders (TIWB-CI)”**, ku u trajtuan sfidat dhe strategjitë e reja për të forcuar integritetin fiskal dhe luftën kundër evazionit.



Në këtë aktivitet, të mbështetur nga **UNDP**, **OECD** dhe **SECO**, morën pjesë përfaqësues të agjencive ligjzbatuese, ekspertë të huaj dhe drejtues të institucioneve tatimore dhe doganore. Forumi u fokusua në rëndësinë kritike të bashkëpunimit ndërinstitucional për hetimin e krimit financiar dhe flukseve të paligjshme.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, në fjalën e tij theksoi: “Evazioni fiskal nuk mund të luftohet i izoluar. Ai nis në doganë, vijon te tatimet dhe përfundon në pastrim parash. Prandaj, bashkëpunimi mes doganave, tatimeve dhe inteligjencës financiare është thelbësor për një hetim të plotë dhe efektiv.” Ai vuri theksin tek sistemi doganor **ASYCUDA World**, i cili që nga viti 2002 është një burim kyç për regjistrimin e import-eksporteve dhe një shtyllë referimi për të dhënat e INSTAT.

Përveç kësaj, Gazheli përmendi se falë bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me Guardia di Finanza, intelijenca ligjzbatuese shqiptare po fuqizohet në përpunimin e të dhënave dhe analizën e riskut, duke përdorur gjithnjë e më shumë inteligjencën artificiale.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE MERR PJESË NË KONFERENCËN “ALEANCA E GRAVE NË UNIFORMË 2025”

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave mori pjesë në Konferencën vjetore **“Aleanca e Grave në Uniformë 2025”**, një aktivitet i rëndësishëm i cili mbledh së bashku gra dhe vajza që shërbejnë në strukturat e sigurisë, zbatimit të ligjit dhe administratës publike.



Përfaqësueset e Doganës Shqiptare ishin pjesë aktive e punimeve të Konferencës, duke kontribuar me diskutime, përvoja dhe perspektiva profesionale mbi rolin dhe fuqizimin e grave në institucionet e uniformuara.

Gjatë aktivitetit, pjesëmarrëset u angazhuan në panele mbi leadershipin, integritetin, sfidat e profesionit, si dhe rëndësinë e ndërtimit të një mjedisi të barabartë dhe mbështetës për gratë në shërbim publik. Përfaqësueset tona sollën shembuj konkretë të punës së përditshme në administratën doganore, përfshirë sfidat dhe arritjet në fushat e kontrollit kufitar, analizës së riskut, hetimit doganor dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Pjesëmarrja e tyre theksoi angazhimin e Doganës Shqiptare për promovimin e diversitetit, gjithëpërfshirjes dhe rritjes së rolit të grave në të gjitha nivelet e organizatës.